



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 111 Prot

Tiranë, më 26/08/2010

VENDIM Nr. 15 dt. 20.08.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.08.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

I. Lidhur me: Diskutimi i projekteve

1. **Miratohet:** Pikë ekspozimi dhe shitjeje për artizanët në kalanë e Shkodrës, me kondicionin: **Nuk miratohet bar-kafeja e parashikuar në projekt.**
2. **Miratohet:** Ndërhyrje restauruese në murin perëndimor (ndërmjet kullave 7-8), të kalasë së Beratit. **me kondicionin: Me lekët që do të teprojnë nga zbatimi i projektit të bëhet zbarkimi 2 metër i murit të kalasë.**
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi, banesa me pronarë Thanas, Spiro dhe Sotir Vllaho, Gjirokastrë.
4. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa e Lefter Kolovanit, Jani Dënës, sot në pronësi të Vasilika Gogut, M-112, M-113 lagja Mangalem, Berat.
5. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni banesa e Z. Petraq Simsia, lagja Goricë, Berat.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE